

Pjesëmarrja e KLSH-së në Takimin Ndërkombëtar të Audituesve në datat 11-12 Prill, organizuar në Bernë nga Sekretariati I Shtetit për Bashkëpunim Ekonomik (SECO I Zvicrës)

Në datat 11-12 Prill, u zhvillua në Bernë Takimi Ndërkombëtar i Audituesve, organizuar nga Sekretariati i Shtetit për Bashkëpunim Ekonomik (SECO i Zvicrës).

Gjatë fjalës hapëse të takimit, organizatorët prezantuan një material mbi organizimin, funksionimin dhe rolin e Zyrës Federale të Auditimit të Zvicrës, si autoriteti suprem mbikëqyrës i vendit. Më pas, u vijua me një analizë nga përfaqësuesit e EUROSAT-t mbi bashkëpunimin me auditin e brendshëm, duke paraqitur një përmbledhje të rezultateve, analizës së strategjisë dhe raportit të bashkëpunimit të Konfederatës së Përbashkët Europiane të EUROSAT dhe Njësive të Auditimit të Brendshëm (projekti ECIIA).



Prezantimet pasuese kishin në fokus të tyre bashkëpunimin mes auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, duke paraqitur pikëpamje të ndryshme se si këto njësi bashkëveprojnë në vendet e Europës Lindore.

Në pjesën tjetër të takimit, të pranishmit u ndanë në dy grupe të ndryshme, sipas njësive që ata përfaqësonin, ku audituesit e jashtëm patën mundësi të ndiqnin prezantimet mbi tendencat globale dhe rajonale në pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit, ilustruar me shembuj konkretë nga raporti i INTOSAI për vitin 2023. Gjithashtu, audituesit e jashtëm paraqitën shqetësimet e tyre mbi situatat aktuale të cënimit të pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit. Përfaqësuesit e IDI-t u fokusuan në rolin proaktiv të kësaj strukture për mbështetjen e dhënë ndaj institucioneve supreme dhe prezantimit të mekanizmit (SIRAM), implementuar nga EUROSAT për adresimin e këtyre problematikave, me qëllim zgjidhjen e tyre.

Takimi u finalizua me organizimin e tryezave të rrumbullakëta me përfaqësuesit e njësive të auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm të shteteve të pranishme, në të cilin u diskutua mbi funksionimin e ndërveprimit dhe bashkëpunimit institucional të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Njësive të Auditimit të Brendshëm. Nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave më të mira dhe arritjeve kryesore në këtë drejtim, u trajtua perspektiva për zhvillimin e mëtejshëm, duke forcuar hallkat e komunikimit dhe ndërmarrjes së hapave konkretë për të nxitur këtë bashkëpunim. Në këtë takim KLSH u përfaqësua nga audituesja e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, znj. Joana Troqe.